

BREAKING NEWS

x

ULET NUMRI I TE INFEKTUARVE ME COVID-19 NE SHQIPERI , JA ÇFARE KA NDODHUR ...

AKTUALITET

Lezhë/ 35-vjeçari qëllohet me armë në lokal, identifikohet dhe shpallet në kërkim autori

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
28 MAJ 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Të shtëna me armë zjarri janë shënuar mbrëmjen e së dielës edhe në qytetin e Lezhës, por fatmirësisht ndryshe nga atentati në Vlorë, në qytetin verior nuk kishte viktimë. Mësohet se nga të shtënat me armë zjarri mbeti i plagosur një 35-vjeçar, por fatmirësisht ai ndodhet nën kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

Ngjarja ndodhi në orët e vona të mbrëmjes të së dielës në lagjen "Gurra" të qytetit të Lezhës, ndërsa i plagosuri është shtetasi Ridvan Koça, 35 vjeç. I plagosuri ka qenë duke pirë kafe në një lokal kur një person është afruar dhe ka qëlluar katër herë me pistoletë në këmbë 35-vjeçarin dhe më pas është larguar duke humbur gjurmët, ku ka përfituar dhe nga errësira. I plagosuri u dërgua menjëherë në spitalin rajonal të Lezhës për ndihmë mjekësore. Burime nga bluzat e bardha bëjnë me dije se i riu kishte marrë dy plumba në këmbë dhe pas ndërhyrjes kirurgjikale për heqjen e tyre, mjekët thonë se gjendja e 35-vjeçarit është e stabilizuar dhe se ai ndodhet në reanimacion jashtë rrezikut për jetën. Menjëherë pas ngjarjes policia e Lezhës shkoi në lokalin ku dhe ndodhi ngjarja dhe shoqëroi për të marrë në pyetje personat që ndodheshin aty kur ndodhi ngjarja. Ndërkohë grupi hetimor ka shkuar dhe në spitalin rajonal të Lezhës, ku ka marrë në pyetje të plagosurin, por ai ka thënë përpara hetuesve se nuk ka konflikte dhe se nuk e ka njohur atentatorin. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan 4 gëzhoja pistoleta si dhe kamerat e sigurisë së lokalit dhe bizneseve të tjera ku ndodhi ngjarja.

Identifikohet autori

Pa kaluar 24 orë nga plagosja e Ridvan Koçit në një lokal në qytetin e Lezhës mbrëmjen e së dielës, policia e këtij qytetit ka arritur të identifikojë autorin dhe ta shpall në kërkim atë. Burime zyrtare bënë me dije mesditën e djeshme se autori i plagosjes së të riut Koçi, është 37-vjeçari me inicialet P. K.. Sipas policisë ky shtetas nuk është një emër i panjohur për uniformat blu pasi ai është person me precedent të mëparshme penale. 37-vjeçari ka qenë i dënuar më parë për pengmarrje. Pas identifikimit të autorit të ngjarjes Policia e Lezhës në bashkëpunim me Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë të Shkodrës janë vënë në kërkim të autorit të kësaj ngjarjeje dhe po punojnë për kapjen e tij dhe vënien përpara autoriteteve ligjzbatuese. Nuk dihen shkaqet dhe rrethanat që çuan në plagosjen e Koçit, pasi edhe vetë i

plagosuri nuk ka ndihmuar grupin hetimor duke u shprehur se nuk e njihen autorin. Ndërsa zyrtarisht policia thotë se konflikti mes këtyre ka ndodhur për motive të dobëta por pa i thënë ato. Ka qenë kqyrja e kamerave të sigurisë si dhe dëshmitë e dëshmitarëve okular ato që kanë identifikuar autorin e plagosjes të 35-vjeçarit mbrëmjen e së dielës në Lezhë. “Në lidhje me ngjarjen e ndodhur mbrëmjen e djeshme në një lokal në qytetin e Lezhës, ku mbeti i plagosur me armë zjarri një shtetas, Policia ngriti një grup të posaçëm hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për zbardhjen e kësaj ngjarjeje. Nga tërësia e veprimeve hetimore rezultoi se gjatë një konflikti për motive të dobëta, shtetasi me inicialet P. K., 37 vjeç, banues në Lezhë, i dënuar me parë për veprat penale "Heqja e paligjshme e lirisë" dhe "Mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake", ka plagosur me armë zjarri shtetasin Ridvan Kpçin. Policia e Lezhës vijon kontrollet intensive për gjetjen dhe kapjen e autorit të dyshuar, i cili është shpallur në kërkim. Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për veprime të mëtejshme hetimore, për veprat penale “Plagosja e rëndë me dashje” dhe “Mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”, parashikuar nga nenet 88 dhe 278/2 të Kodit Penal”, sqaroi zyrtarisht policia pas ngjarjes së rëndë e cila fatmirësisht përfundoi pa viktima./ **Elvis Myrta**

YOU MAY LIKE

by **mgid**

Već za 3 dana krvni sudovi će ponovo biti kao sa 20 godina!

HYPERTEA